



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 31.1.2025

Nr: 51

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË KORPORATËS
SË INVESTIMEVE SHQIPTARE, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR 2025**

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

SUBJEKT: Korporata e Investimeve Shqiptare

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Korporatës së Investimeve Shqiptare për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Korporata e Investimeve Shqiptare ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 1 (një) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 13.00, në njësinë Administrative nr. 5, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, “Kompania franceze Inetum Consulting po realizon një studim mbi investimet në sektorin digjital në Shqipëri. Ky

Data: 31.1.2025 Nr: 51
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Korporatës së Investimeve Shqiptare për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

projekt ka për qëllim zhvillimin e Shqipërisë në strukturimin e strategjisë së saj lidhur me digjitalizimin, duke krijuar njëkohësisht lidhje me kompani dhe investitorë francezë.”

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Korporatës së Investimeve Shqiptare, një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t'i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Korporatës së Investimeve Shqiptare ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: *“Bazuar në nenin 92 të Kodit Zgjedhor, më datë 20 Janar 2025, kemi raportuar zhvillimin e tryezës së diskutimeve me temë mbi investimet në sektorin digjital në Shqipëri të realizuara nga kompania franceze Inetum Consulting. Nga ana jonë është bërë një gabim material gjatë raportimit duke shënuar si datë aktiviteti gabimisht datën 24.01.2025. Menjëherë sapo kemi konstatuar këtë fakt kemi kryer raportimin me datën e saktë të takimit sikurse verifikohet edhe në sistemin tuaj.*

Nga verifikimet e kryera në ndërfaqen e raportimeve NRI, rezulton se ky aktivitet është raportuar sërish brenda afatit ligjor.

Për sa më sipër, pasi u njoha me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerësoj se veprimtaria publike e raportuar nga Korporata e Investimeve Shqiptare, nuk përbën shkelje sipas parashikimeve të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar. Pasi veprimtaria ka marrë shënimin si “E Ndaluar” në NRI, Korporata e Investimeve Shqiptare nuk e ka zhvilluar këtë aktivitet por e ka riraportuar atë me datën e zhvillimit duke respektuar afatet ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Korporatës së Investimeve Shqiptare.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Illirjan CELIBASHI